

No. 1969 Data 19.10.2023
GJILAN

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan, në cilësinë e panelit intervistues dhe vlerësues, mbi bazën e vlerësimeve individuale të panelistëve dhe vlerësimit dhe poentimit mesatar të dalë nga vlerësimet individuale, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, neni 21, pas zhvillimit të procedurave të konkursit publik nxjerr këtë:

V E N D I M

Për pozitën **Zyrtar për Auditim të Brendshëm** në KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan, sipas konkursit publik me nr. ref. 1324, i publikuar me datë 01.09.2023, Artan Hajdini prej gjithsej 30 pikëve maksimale është vlerësuar me 25 pikë si kandidati më i suksesshëm për këtë pozitë, bazuar në mesataren e pikëve nga panelistët.

A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087 dhe kërkesave të përgjithshme të konkursit publik me nr. të referencës 1324, i publikuar me datë 01.09.2023, ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kandidatët e pakënaqur me këtë vendim mund të ushtrojnë ankesë në KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, në afatin prej 8 (tetë) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ankesat të dërgohen në email adresën rekrutimi.hidromorava@gmail.com.



Komisioni i Auditimit
Kryesuesja

(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)

Gjilan,
Datë: 19.10.2023